

## Vaksinat e fëmijës suaj

### Informacion për prindërit dhe kujdestarët që kanë ardhur në Irlandë nga vende të tjera

Në këtë broshurë do të gjeni informacione rreth vaksinave për fëmijën tuaj. Vaksinat ndihmojnë për ta mbajtur fëmijën tuaj të shëndetshëm, duke e mbrojtur atë nga sëmundjet infektive të parandalueshme. Shërbimi Shëndetësor Irlandez (Ekzekutivi i Shërbimit Shëndetësor) po organizon ekipe vaksinimi për të ofruar vaksinime përmes klinikave. Disa njerëzve do t'u ofrohen vakcina nga ekipet e lëvizshme të vaksinimit. Një anëtar i ekipit të vaksinimit plotësues mund t'ju kontaktojë për vaksinimin e fëmijës suaj.

#### Pse janë të rëndësishme vaksinat?

Vaksinat mbrojnë foshnjat dhe fëmijët nga infeksionet që mund t'i bëjnë ata të sëmurën rëndë. Foshnjat shumë të vogla janë më të rrezikuara nga këto infeksione, kështu që vaksinat fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur.

Në Irlandë, kalendari i vaksinimit fillon në moshën 2 muajshe dhe vaksinat e rekomanduara bëhen në 5 vizita te mjeku juaj i familjes (i njohur si mjeku i përgjithshëm ose GP) kur fëmija juaj është 2, 4, 6, 12 dhe 13 muajsh. Vaksinat që u bëhen foshnjave në Irlandë i mbrojnë ata kundër infeksioneve që janë të zakonshme ose shumë serioze në Irlandë.

2 muaj	Vizita 1	6 në 1 + PCV + MenB + Rotavirus 3 injeksione + pika nga goja
4 muaj	Vizita 2	6 në 1 + MenB + Rotavirus 2 injeksione + pika nga goja
6 muaj	Vizita 3	6 në 1 + PCV + MenC 3 injeksione
12 muaj	Vizita 4	MMR + MenB 2 injeksione
13 muaj	Vizita 5	Hib/MenC + PCV 2 injeksione

#### Cilat vakcina rekomandohen në Irlandë?

Për fëmijët rekomandohen vakcina për t'i mbrojtur ata nga infeksionet në Irlandë, të cilat janë të zakonshme në Irlandë dhe që mund bëjnë që fëmijët të sëmurën rëndë.

#### Cilat janë ndryshimet midis vaksinave të bëra në vendet e tjera dhe vaksinave që bëhen në Irlandë?

Shumë nga vaksinat që bëhen në Irlandë jepen edhe në vende të tjera. Për shembull, vaksinat për të mbrojtur kundër difterisë, poliomielitit, tetanozit dhe fruthit u jepen fëmijëve në shumicën e vendeve.

Mund të ketë dallime në disa nga vaksinat e rekomanduara në Irlandë në krahasim me ato në vendet e tjera. Kjo për shkak se mund të ketë ndryshime midis sëmundjeve që janë të zakonshme në Irlandë

në krahasim me vendet e tjera. Për shembull, në Irlandë ne japim vakcina që mbrojnë fëmijët kundër sëmundjes së meningokokut B dhe C. Këto infeksione mund të shkaktojnë meningjit dhe septicemi. Këto vakcina nuk janë pjesë e kalendarit të imunizimit në disa vende. Por këto rekomandohen në Irlandë për të mbrojtur fëmijët kundër këtyre infeksioneve shumë të rënda.

### **Fëmija im i ka bërë të gjitha vaksinat në një vend tjetër. Pse i duhen vakcina të tjera tani që është në Irlandë?**

Meqenëse fëmija juaj tani jeton në Irlandë, ai duhet të ndjekë kalendarin e vaksinimit të Irlandës. Vaksinat e rekomanduara në Irlandë mbrojnë fëmijët nga sëmundjet që janë të zakonshme në Irlandë ose që mund të kenë pasoja të rënda.

Fëmija juaj duhet të "plotësohet" me vaksinat që rekomandohen në Irlandë. Ai nuk ka nevojë të përsërisë vaksinat që i ka bërë tashmë në një vend tjetër.

### **Nga cilat sëmundje e mbrojnë fëmijën tuaj këto vakcina shitesë?**

#### **Vaksina orale e rotavirusit**

Rotavirusi është një infeksion viral që shkakton diarre dhe të vjella te foshnjat dhe fëmijët e vegjël. Shumica e fëmijëve do të shërohen në shtëpi, por disa duhet të shtrohen në spital. Rreth 880 fëmijë nën moshën 5 vjeç shtroheshin në spital me infeksion rotavirus çdo vit në Irlandë përpara se të futej vakcina e rotavirusit. Ky numër ka rënë në mënyrë dramatike që kur është futur vakcina e rotavirusit.

Vaksina e rotavirusit mund t'u jepet vetëm foshnjave nën moshën 8 muajshe.

#### **Vaksina e meningokokut B (MenB)**

Vaksina MenB ndihmon për të mbrojtur fëmijën tuaj nga sëmundja e meningokokut B. Ky është një infeksion bakterial i rëndë që mund të shkaktojë meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit) dhe septicemi (helmim i gjakut). Meningokoku B shkakton shumicën e infeksioneve dhe vdekjeve nga meningjiti i fëmijëve të vegjël në Irlandë. Vaksina MenB nuk jepet pas moshës 2 vjeçare.

#### **Vaksina e meningokokut C (MenC)**

Vaksina MenC ndihmon për të mbrojtur fëmijën tuaj nga sëmundja e meningokokut C. Ky është gjithashtu një infeksion bakterial i rëndë që mund të shkaktojë meningjit (inflamacion i cipës rrethuese të trurit) dhe septicemi (helmim i gjakut). Mund të ketë edhe vakcina të tjera të rekomanduara për fëmijën tuaj. Mjeku ose infermierja juaj do t'ju këshillojë.

#### **Vaksina e pneumokokut (PCV13)**

Vaksina PCV13 mbron kundër sëmundjes që shkaktohet nga bakteret e pneumokokut.

Këto baktere mund të shkaktojnë sëmundje të tilla si meningjiti (inflamacion i rreshtimit rreth trurit), pneumonia (një infeksion i mushkërive) ose septicemi (helmim i gjakut).

### **Cilat janë efektet anësore të këtyre vaksinave?**

Efektet anësore pas vaksinave duhet të zgjasin vetëm për disa ditë

**Pas vaksinës menB** fëmija juaj mund të ketë ethe (temperaturë e lartë) ose të ketë siklet, skuqje dhe ënjtje në vendin ku është bërë injeksioni.

**Pas vaksinës menC** fëmija juaj mund të ketë siklet, skuqje dhe ënjtje në vendin ku është bërë injeksioni ose të ketë ethe apo të jetë nervoz.

**Pas vaksinës së rotavirusit** fëmija juaj mund të ketë diarre të lehtë. Shumë rrallë mund të kenë dhimbje barku ose të zhvillojnë skuqje.

### **Ku mund ta vaksinonj fëmijën tim?**

Në Irlandë, mjekët e familjes (GP) ose Programi i Vaksinimit Plotësues për Migrantët ofrojnë vaksinim për fëmijët refugjatë dhe që kanë aplikuar për mbrojtje. Infermierja zakonisht u bën foshnjave vaksinat e tyre, nën drejtimin e mjekut të përgjithshëm. Mund të ketë klinika të tjera të organizuara nga shërbimi shëndetësor për t'u bërë fëmijëve vaksinat që u nevojiten.

### **Si mund të caktoj një takim me një mjek të përgjithshëm?**

Juve ju duhet të rezervoni një takim me një mjek të përgjithshëm; për informacion se si të gjeni një mjek të përgjithshëm, shihni informacionin në <https://www2.hse.ie/services/find-a-gp/>.

Nëse nuk keni një mjek të përgjithshëm, ekipi lokal i vaksinimit plotësues do t'ju kontaktojë.

### **Çfarë ndodh në vizitën e vaksinimit?**

Përpara bërjes së vaksinave, një anëtar i ekipit lokal të vaksinimit plotësues, një mjek i përgjithshëm ose një infermiere do t'ju flasë për vaksinat që i nevojiten foshnjës tuaj dhe ju shpjegon për secilën vaksinë. Pas marrjes së vaksinave, një anëtar i ekipit lokal të vaksinimit plotësues, mjeku i përgjithshëm ose infermierja do t'ju japë një dokument 'Kartela e vaksinave' që përmban në mënyrë të detajuar vaksinat që ka bërë fëmijë juaj. Është shumë e rëndësishme që ta ruani të sigurt kartelën e vaksinave, si një dokument të historisë së vaksinimit të fëmijës suaj. Është e rëndësishme që ta merrni me vete këtë dokument në çdo vizitë tjetër vaksinimi.

### **A duhet të paguaj për vaksinimin?**

Jo. Vaksinimi është falas në Irlandë.

### **A ka ndonjë vaksinë që rekomandohet për fëmijët më të rritur?**

Kur fëmijët janë në shkollë, atyre u rekomandohen vaksina

Në fëmijët e vegjël (5 vjeç):

Vaksina MMR dhe një dozë përforcuese e vaksinave të difterisë, tetanozit, pertusis (kolla e mirë) dhe poliomielitit që bëhen në shkollë.

Në vitin e 1-rë të shkollës së mesme (12 vjeç):

Vaksina HPV, MenACWY (ACWY e meningogokut) dhe një dozë përforcuese e vaksinave të difterisë, tetanozit dhe pertusis (kolla e mirë) që bëhen në shkollë.

### **A ka ndonjë vaksinë që rekomandohet për të rriturit?**

Po. Të rriturit që nuk kanë marrë disa vaksina rekomandohet që t'i marrin ato. Për shembull, vaksina MMR që mbron nga shytat, fruthi dhe rubeola rekomandohet për të rriturit që nuk e kanë marrë kurrë këtë vaksinë. Bisedoni me një anëtar të ekipit lokal të vaksinimit plotësues, me mjekun tuaj të familjes (GP) ose infermieren.

### **Kam disa pyetje në lidhje me vaksinimin, me kë mund të flas?**

Bisedoni me një anëtar të ekipit lokal të vaksinimit plotësues, me mjekun tuaj të përgjithshëm ose me infermieren. Nëse klinikat e tjera janë organizuar nga shërbimi shëndetësor për t'u bërë vaksina fëmijëve, për këtë mund të flisni gjithashtu me mjekun ose infermieren në këto klinika.

### **Ku mund të gjej më shumë informacion?**

Vizitoni [www.immunisation.ie](http://www.immunisation.ie)